



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:081509

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05435604

**P.nr.467/2016**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurit: D. P., për shkak të veprës penale: Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31, të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje:KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.551/2014 e datës 08.06.2026, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit; ND.nr.751/2023, të datës 08.03.2024, të lidhur në mes të pandehurit: D. P. dhe të dëmtuarit: I. M., jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par.1 nën par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP), dhe në mbështetje të nenit 2 par. 2, nenit 8, dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me datë 11.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I.APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit; ND.nr.751/2023, të datës 08.03.2024, e lidhur në Zyrën e Ndërmjetësimit pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në mes palëve, të pandehurit: D. P., në njërën anë dhe të dëmtuarit I. M., në anën tjetër.

II.HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.551/2014 e datës 08.06.2016, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

D. P., nga i ati P., e ëma Zh., e vajzërisë M., i lindur Mitrovicë me datë ... , me vendbanim në rr.“...”, komuna Mitrovicë Veriore, me numër personal: ..., ka të kryer shkollën e mesme-teknik i makinerisë, me profesion automekanik, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

III.Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II. nr.551/2014 e datës 08.06.2016, ndaj të pandehurve: Zh. P. dhe D. P., për shkak të veprës penale: Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale sa i përket të pandehurës Zh. P., kjo Gjykatë ka marrë aktvendimin P.nr.467/16 të datës 20.02.2022, për pushimin e procedurës për shkak të vdekjes së të pandehurës, ndërsa procedura penale ka vazhduar vetëm ndaj të pandehurit D. P..

Gjykata me datë 19.12.2023, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën seancë kanë prezentuar: Prokurori i Shtetit Albana Parduzi, i pandehuri D. P., i dëmtuari I. M. si dhe përkthyesja e gjykatës R. C..

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, i pandehuri D. P. ka propozuar që kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit sepse me palën e dëmtuar I. M. janë pajtuar dhe kanë lidhur një marrëveshje të cilën ia kanë dorëzuar gjykatës.

Po ashtu pala e dëmtuar I. M. deklaroi se, e përkrah në tërësi propozimin e të pandehurit dhe është i gatshëm që të lidhi marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, meqenëse lokali i është liruar.

Prokurori i Shtetit Albana Parduzi deklaroi se, pasi që i dëmtuari dhe i pandehuri deklaruan se këtë çështje dëshirojnë që ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit dhe meqenëse plotësohen kushtet ligjore pajtohet që kjo çështje të referohet në procedurën e ndërmjetësimit.

Pas dhënies së pëlqimit nga ana e palëve në procedurë, lidhur me referimin e kësaj lënde në procedurë të ndërmjetësimit, Gjykata konform dispozitave ligjore të ligjit për Ndërmjetësim, këtë çështje penale e referoi në procedurë të ndërmjetësimit.

Me datën 08.03.2024, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë është arritur Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.751/2023, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit: D. P. dhe të dëmtuarit: I. M., të cilën marrëveshje gjykata e ka pranuar me datë 08.03.2024. Të dy palët kanë deklaruar se këtë marrëveshje e kanë arritur me vullnet të plotë dhe pa asnjë presion, njëkohësisht të dy palët kanë deklaruar se heqin dorë nga çdo kërkesë pasurore apo juridike lidhur me këtë rast.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 2 par.2, dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve e duke u bazuar në nenin 357 par. 1 nën par.1.3 të KPP-së, vendosi që të hedhë akuzën dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit D. P..

Konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 11.03.2024, do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 par.1 të KPP-së, pasi që është pushuar procedura penale, ndërsa që i pandehuri i ka paguar vetë shpenzimet e ndërmjetësimit në atë procedurë.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par. 1 nën par.1.3 të KPP-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.467/2016, datë: 11.03.2024**

**G j y q t a r j a:**  
Benita Berisha

---

**KËSHILLË JURIDIKE;** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.